



**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa Rruga "Sami Frasheri", nr. 10, Tiranë
Tel/Faks +355 4 234885
E-mail prokurimet@albaniandf.org
Ueb-faqe www.albaniandf.org

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
E-mail prokurimet@albaniandf.org

3. Lloji i procedurës së prokurimit: "E hapur"

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: "Kontratë për punë publike"

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-23985-10-10-2024

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Nxitja e ndërveprimit dhe frymës komunitare, gjallërimi i jetës socio-kulturore në zona me potencial zhvillimi nëpërmjet rijetëzimit të aseteve publike: Rikonstruksion Qendra Kulturore Komunitare "Dhimitër Orgocka", Maliq".

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punë Ndërtimi- 45000000-7

8. Fondi limit : 110,293,174.85 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor 100 Fshatrat për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 24AD501

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

- Zbatim i pikës 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar e cila përcakton se: *"Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce"*.
- Gjatë rishikimit të dokumentacionit për prokurimin, është vënë re që nuk janë bërë kombinimet e nevojshme për zërat që lidhen me punimet elektrike, edhe pse këto janë të përfshira në tabelën përmbledhëse. Për të adresuar këtë çështje, bashkëngjisim preventivin e rishikuar, ku janë përfshirë dhe përditësuar të gjitha zërat e punimeve elektrike.

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: _____

(Nuk ka ndryshim të afateve pasi Ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave)

SHTOJCË NR.1

Sot më datë 17.10.2024, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ju bën me dije se:

Në zbatim të pikës 2 të nenit 75 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar e cila përcakton se: “*Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce*”, AK-ja rishqyrtoi edhe një herë preventivin e zbatimit të punimeve, për shkak se gjatë rishikimit të dokumentacionit për prokurimin, është vënë re që nuk janë bërë kombinimet e nevojshme për zërat që lidhen me punimet elektrike, edhe pse këto janë të përfshira në tabelën përmbledhëse. Për të adresuar këtë çështje, bashkëngjisim preventivin e rishikuar, ku janë përfshirë dhe përditësuar të gjitha zërat e punimeve elektrike.

Për sa më sipër, ju njoftojmë se dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit me : **REF-23985-10-10-2024**, me objekt: “Nxitja e ndërveprimit dhe frymës komunitare, gjallërimi i jetës socio-kulturore në zona me potencial zhvillimi nëpërmjet rijetëzimit të aseteve publike: Rikonstruksion Qendra Kulturore Komunitare “Dhimitër Orgocka”, Maliq”.

Fondi limit: 110,293,174.85 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor 100 Fshatrat për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 24AD501

do të sqarohen/ ndryshohen/ modifikohen sipas preventivit të rishikuar, ku janë përfshirë dhe përditësuar të gjitha zërat e punimeve elektrike.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e ofertave nuk ndryshon.

Kjo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.